

**Albanisch**

**Pagesat plotësuese (EL) të pensionit të pleqërisë (AHV) dhe pensionit të invaliditetit (IV)**

**Çka janë pagesat plotësuese?**

Pagesat plotësuese janë komponentë e rëndësishme e sigurimeve sociale (shtylla e parë). Po që se plotësohen parakushtet ligjore, ekziston – po ashtu si për pension pleqërie të AHV apo pension invaliditeti - një e drejtë ligjore për pagesa plotësuese.

**Kush ka të drejtë për pagesat plotësuese?**

Të drejtën e pagesave plotësuese e kanë marrëset dhe marrësit e kontributeve të pensionit të pleqërisë apo të pensionit të invaliditetit, të ardhurat e të cilave / cilëve janë nën minimalen e ekzistencës sociale.

Ekzistenca minimale sociale përcaktohet sipas rregullave të shumta llogaritëse ligjore. Kush dëshiron ta dijë, se a ka të drejtë për pagesa plotësuese mund ta përdorë këtë rregull të rëndësishme për buxhetin mujor:

	Të ardhurat e përgjithshme
./.	Premia e sigurimit shëndetësor
./.	Qiraja
	-----
	Të ardhurat neto
	=====

Po që se të ardhurat neto të personave që jetojnë vetëm janë afërsisht nën 1'620 franga dhe te bashkëshortet afërsisht nën 2'431 franga në muaj, rekomandohet që të bëhet shqyrtimi i mundësisë së të drejtës për pagesa plotësuese. Te familjet me fëmijë shumë e posa shënuara rriten afërsisht 847 franga për fëmijë.

Po që se dikush jeton në një shtëpi për pleq vlejné kritere të tjera. Enti i Pleqërisë dhe i Sigurimeve të qytetit të Bernës ju informon me kënaqësi (shih më poshtë: **Kush përgjigjet në pyetje të tjera?**).

**Çfarë roli luan pasuria?**

Fitimi (p.sh. interesi nga kontoja e kursimeve) nga pasuria e përgjithshme njehsohet me të ardhurat e tjera.

Ata që jetojnë vetëm mund t'i zbresin 37'500 franga nga pasuria, kurse bashkëshortët 60'000 franga. Te familjet me fëmijë rritet shuma e liruar e pasurisë në 15'000 franga për fëmijë. Nga shuma e mbetur merren zakonisht 10%. Kjo shumë trajtohet në kuadër të llogaritjes së pagesave plotësuese si të ardhura shtesë (për buxhetin mujor 1/12 e saj).

Banimi në pronën e vet njehsohet me të ardhurat e tjera vetëm nëse vlera (zyrtare) e pronës e tejkalon shumën prej 112'500 franga.

### ***A duhet të kthehen prapa shumat e pagesave plotësuese?***

Pagesat plotësuese të marra ligjërisht kurrsesi nuk duhet të kthehen prapa – dhe as nga trashëgimtarët dhe trashëgimtarët. Përkundrazi pagesat plotësuese të marra pa të drejtë duhet të kthehen tërësisht prapa.

### ***Kush i pranon kërkesat për pagesat plotësuese?***

Dega e Sigurimit për Pleqërinë dhe Trashëgimtarët e vendbanimit i pranon kërkesat për pagesat plotësuese. Në qytetin e Bernës kjo është në Entin i Pleqërisë dhe Sigurimeve të qytetit.

### ***Kush përgjigjet në pyetje të tjera?***

Pensionistet dhe pensionistët, që jetojnë në qytetin e Bernës, mund të drejtohen te Enti i Pleqërisë dhe Sigurimeve të qytetit të Bernës. Këtu punonjëset dhe punonjësit vihen në dispozicion me këshilla dhe vepra dhe ndihmojnë me kënaqësi që të parashtrihen kërkesat për pagesa plotësuese. Lajmërimi më parë në telefon (031 321 66 89) është shumë i preferuar.

AHV-Zweigstelle der Stadt Bern  
Bundesgasse 33  
3011 Bern

### **A dëshironi të dini më shumë për pagesat plotësuese (EL)?**

Enti i Pleqërisë dhe Sigurimeve i qytetit të Bernës mban rregullisht takime informative. Pjesëmarrëset dhe pjesëmarrësit informohen për pikat kryesore të pagesave plotësuese (EL) dhe njëherazi ata mësojnë se çfarë shërbimesh ofron qyteti për fazën pas profesionit (punës). Për të parashtruar pyetje apo për t'u këshilluar individualisht ekzistojnë raste të mjaftueshme.